

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN BALLDREN I RI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Balldren i Ri, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Lezhë, me objekt:“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 154, datë 03.12.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 767/11, datë 03.12.2015, i ka rekomanduar z. Fran Frrokaj, Kryetar i Bashkisë Lezhë, në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE;

1. Gjetje nga auditimi: Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

-Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listë pagesat e sigurimeve shoqërore.

-Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit.

-Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.

-Specifikimet teknike janë të përgjithshme.

-Liçensë profesionale për tregtimin e karburantit;

-Certifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë.

Rekomandim:Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa që grupet e ngritura për llogaritjen e fondit limit dhe NJV të zbatojnë procedurat e caktuara dhe të vlerësojnë drejt kriteret që vendosen për procedurën e prokurimit dhe operatorët pjesëmarrës.

2. Gjetje nga auditimi: Në dosjet e tenderit nuk dokumentohen dhe argumentohen plotësisht nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit të nevojshëm. Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç” .

Rekomandim: Për një përdorim me efektivitet, eficientë të fondeve publike, Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të argumentojë domosdoshmërinë e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi , në varësi të fondeve në dispozicion për sasi të që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen, duke përcaktuar me hollësi specifikimet teknike, këto në zbatim të programimit të bërë në fillim të vitit.

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të dokumenteve të bankës, u konstatuan në mjaft raste të kryerjes së prokurimit të fondeve publike, me procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla dhe disa mangësi në drejtim të moszbatimit të Urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 15 e 22 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar e kontrollin” .

3. Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri të marrë masa, duke argumentuar domosdoshmërinë për zbatimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla, administruar kërkesat nga sektorët e interesuar, si dhe llogaritja e fondit limit të bëhet sipas kërkesave ligjore dhe përcaktimeve të gjurmëve standarde të zhvillimit të procedurës.

4. Gjetje nga auditimi Në auditimin e të dhënave të Zyrës së Taksave konstatohet se deri në datën 30.6.2015 rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh), në vlerën prej *4,655,501 lekë*.

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël në vlerën 773,778 lekë për vitin 2013, debitorët e taksave dhe tarifave vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitet për vitin 2014 në vlerën 1,186,170 dhe për vitin 2015 në shumën 1,142,643 lekë, ku përfshihet detyrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën 1,552,910 lekë .

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa nëpërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Lezhë, për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa arkëtuara deri më datën 30.6.2015 në vlerën *4,655,501 lekë*.

5.Gjetje nga auditimi: IMKTV nuk ka kryer asnjë kontroll në drejtim të plotësisimit të dosjes së objekteve me dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe ligjor.

Nuk është kryer asnjë kontroll në drejtim të marrjes së masave të sigurimit teknik dhe mjetet mbrojtëse të jetës së puntorëve, për rrjedhojë nuk janë mbajtur proces verbale përkatëse. Në terren nuk janë kryer aksione në bashkëpunim me strukturat policore, për lirim të hapsirave publike, shembjen e mureve, prishjen e kioskave, lirim të trotuarëve të këmbësorëve etj. IMKTV për 7 ndërtime të paligjshme nuk ka vendosur sanksione, pasi vendimet e pezullimit nuk janë shoqëruar me vendime prishje dhe gjoba, si dhe kallëzime penale.

Për periudhën 01.06.2013 deri me 31.07.2015 IMKTV, nuk ka vendosur asnjë gjobë, për 28 vendimet e pezullimit dhe nuk është bërë asnjë kallëzim penal.

Mungesa e kontroleve të kryera në territorin që ky Inspektorat administron, për evidentimin e objekteve me dhe pa leje ndërtimi, si dhe hartimin e regjistrave përkatës sipas zonave, ka bërë që të mungojë inventari i plotë i ndërtimeve pa leje.

Në disa raste, ku megjithëse ka kaluar afati i zbatimit të vendimeve të marrë nga IMKTV, nga kjo e fundit nuk është ndërhyrë për zbatimin e procedurave të mëtejshme ligjore .

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa që IMKTV të bëjë evidentimin e objekteve pa leje ndërtimi, si dhe të hartojë regjistrat përkatës sipas zonave sëbashku me inventarin e plotë të ndërtimeve pa leje.

6.Gjetje nga auditimi: Komuna Balldren nuk ka bërë miratimin e “Kërkesës për fillimin e procesit të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të Komunës Balldren”, në ndjekje dhe zbatim të procedurave përkatëse ligjore të planifikimit, plan i cili do të përfshijë si prioritet hartimin e masterplanit të përgjithshëm për territorin e komunës dhe i cili ngarkon Kryetarin e Komunës Balldren dhe zyrën e urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi. Kjo nismë nuk i është dërguar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Plani Strategjik i Përgjithshëm Vendor i Komunës Balldren nuk është miratuar .

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa për fillimin e procesit të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të Komunës Balldren dhe të hartohet Plani Strategjik i Përgjithshëm Vendor, duke zbatuar procedurat ligjore dhe bashkëpunuar me AKPT.

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer është konstatuar se *nuk ka urdhër nga titullari, për ngritje komisioni për marrjen në punë dhe verifikimin e dokumentacionit të policëve të*

komunës. Procedura për përzgjedhjen e kandidatëve për punonjës policie të komunës, nuk është kryer në bazë të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 i ndryshuar .

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa për rastet e rekrutimit të punonjësve të policisë bashkiake apo strukturave të tjera, të krijojë komision dhe të vendosen kriteret të qarta, duke i plotësuar ato sipas kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për policinë e bashkisë dhe komunave”.

B. MOSPËRDORIM ME EFEKTIVITET I FONDEVE PUBLIKE(3E)

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimit nr. 114, datë 24.9.2013, për shumën 379,800 lekë ishte paguar personi fizik “Lezha TV” mbështetur në faturën tatimore nr. 55, datë 24.9.2013 me përshkrimin “Shërbime televizive, njoftime për biznesin, sensibilizim investimesh, njoftim pagesa taksash, mesazhe sensibilizuese mbi mjedisin, urime festash, aktivitete të ndryshme”. Procedura ka filluar me nxjerrjen e urdhër prokurimit nr. 1, datë 18.9.2013 me fond limit 316,500 lekë pa TVSH me objekt “Pagesë televizive 1 vjeçare për njoftime të ndryshme, urime dhe mesazhe sensibilizuese”. Data e zhvillimit të tenderit është caktuar më 19.9.2013. Në tender kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. Në datën 24.9.2013 nga Autoriteti Kontraktor njoftohet z. F.S, se si operator ekonomik pjesëmarrës në konkurrim i renditur i dyti, ftohet të jetë fitues, pasi operatori ekonomik i renditur i pari, nuk është paraqitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, rezulton se:

- Nuk ka kërkesë për argumentimin e domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit;
- Nuk është ngritur grup pune për llogaritjen e fondit limit dhe as llogaritje e argumentim se si ka dalë fondi limit;
- Në dokumentet e tenderit nuk ka të përcaktuar sa njoftime do të bëhen në televizion, sa do të jetë koha televizive dhe sa do të jenë tarifat;
- Në dokumentet e tenderit nuk ka asnjë nënshkrim të anëtarëve të komisionit për blerje me vlera të vogla për zbatimin e procedurës, deri në shpalljen e fituesit;
- Pagesa është kryer në datën 24.9.2013, menjëherë pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik, pa u kryer asnjë punë.
- Në faturën tatimore nuk është përcaktuar vlera e TVSH-së, megjithëse shuma është me TVSH, edhe pse subjekti është person fizik;

Për sa më lart, për kryerjen e pagesës **në shumën 379,800 lekë**, pa u bërë më parë shërbimi dhe pa u dokumentuar.

2. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimit nr. 115, datë 24.7.2014, për shumën 384,000 lekë ishte paguar personi fizik “L.....” mbështetur në faturën tatimore nr. 35, datë 22.7.2014 me përshkrimin “Shërbime televizive, njoftime për biznesin, sensibilizim investimesh, njoftim pagesa taksash, mesazhe sensibilizuese mbi mjedisin, urime festash, aktivitete të ndryshme”. Për sa më lart, për kryerjen e pagesës **në shumën 384,000 lekë**, pa u dokumentuar më parë shërbimi.

1.3. Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të vlerësuar përgjegjësinë për procedurat e kryera në blerjen e shërbimit nga shoqëria “T....L” shpk, me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **763,800 (379,800 lekë + 384,000 lekë)**, pagesë e kryer me dokumenta të pa plotësuar dhe pa u nënshkruar fatura nga anëtarët e komisionit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109,

Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësisia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa, të kryej kontabilizimet e nevojshme dhe të nxjerrë aktet administrative e ndjekë të gjitha shkallët e gjuqësorit për shpërblimi i dëmit **në vlerën 430,120,913 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 43, datë 11.4.2014 me vlerë 340,008 lekë me TVSH ishin kryer pagesa për “Blerje materiale për sistemim rrjeti elektrik dhe lysterje për shkollat e qendrën shëndetësore”, mbi bazën e faturës tatimore nr. 374, datë 27.9.2012, të lëshuar nga subjekti fizik Gjok Smakaj Balldren.

Nga auditimi u konstatua se në praktikën e pagesës dhe në dokumentacionin e Zyrës së Financës:

- Nuk ka dokumentacion të hyrjeve të materialeve në magazinën e Komunës;
- Urdhër prokurimi nr. 28, datë 1.6.2012 i nxjerrë për prokurimin e materialeve është pa fond limit të përcaktuar;
- Nuk ka asnjë dokument ku të kenë disponuar anëtarët e Komisionit për Blerje me Vlera të Vogla për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe të blerjes së materialeve;

Bashkëlidhur dokumenteve ndodhet një situacion dhe akt marrje në dorëzim me vlerën 344,769 lekë me TVSH, e cila nuk është e njëjtë me vlerën e faturës, si dhe nuk shprehet në asnjë rast se si dhe ku janë përdorur materialet.

Në prokurimin e kryer bëhet fjalë për blerje materiale dhe nuk është prokuruar për punë, për kryerje punimesh.

Nuk dokumentohet zhvillimi i prokurimit në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 18.2.2008 “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar dhe se blerja e materialeve nuk rezulton të jetë kryer, përderisa materialet nuk janë bërë hyrje në magazinë dhe për kryerjen e pagesës **në shumën 340,008 lekë**.

Rekomandimi: Shuma prej 340,008 lekë, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Gj... S...al, pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D ish Kryetar i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe znj. D.P, si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

4. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 68, datë 21.5.2014 me vlerë 398,862 lekë me TVSH ishin kryer pagesa për “Blerje materiale për sistemim rrjeti elektrik dhe riparime të pjesshme, lysterje të zyrove të komunës, shkollave kopshteve e qendrën shëndetësore”, mbi bazën e faturës tatimore nr. 2, datë 5.1.2013, të lëshuar nga subjekti fizik Gjok Smakaj Balldren.

Nga auditimi u konstatua se në praktikën e pagesës dhe në dokumentacionin e Zyrës së Financës:

- Nuk ka dokumentacion të hyrjeve të materialeve në magazinën e Komunës;
- Urdhër prokurimi nr. 8, datë 1.6.2012 i nxjerrë për prokurimin e materialeve është pa fond limit të përcaktuar;
- Nuk ka asnjë dokument ku të kenë disponuar anëtarët e Komisionit për Blerje me Vlera të Vogla për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe të blerjes së materialeve;

Bashkëlidhur dokumenteve ndodhet një situacion dhe akt marrje në dorëzim me vlerën 361,305 lekë me TVSH, e cila nuk është e njëjtë me vlerën e faturës, si dhe nuk shprehet në asnjë rast se si dhe ku janë përdorur materialet.

Në prokurimin e kryer bëhet fjalë për blerje materiale dhe nuk është prokuruar për punë, për kryerje punimesh.

Sa më lart konkludohet se nuk dokumentohet zhvillimi i prokurimit në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 18.2.2008 “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar dhe se blerja e materialeve nuk rezulton të jetë kryer, përderisa materialet nuk janë bërë hyrje në magazinë dhe për kryerjen e pagesës **në shumën 398,862 lekë**.

Rekomandimi: Shuma prej 398,862 lekë, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Gjok Smakaj Balldren pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D, ish Kryetar i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe znj. D.P, si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Sistemim pjesor i kanaleve të ujërave të zeza Balldren Kodër” me fond limit 567,646 lekë pa TVSH të zhvilluar në vitin 2014, është shpallur fitues operatori ekonomik Shoqëria “D..I” sh.p.k., i cili është tërhequr nga prokurimi dhe nuk i është mbajtur **sigurimi i ofertës në masën 11,353 lekë**.

Rekomandimi: Shuma prej 11,353 lekë, që përbën vlerën sigurimit të ofertës ti mbahet Shoqërisë “D..I” sh.p.k. për tërheqjen nga prokurimi me objekt “Sistemim pjesor i kanaleve të ujërave të zeza Balldre Kodër”, ku ishte shpallur fitues.

6. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 10, datë 6.2.2014 në shumën 141,469 lekë është kryer pagesa mbi bazën e faturave të thjeshta tatimore nr. 71, datë 31.1.2013 në vlerën 70,129 lekë, për sistemimin e ujërave të zeza Torovicë dhe fatura nr. 72, datë 24.1.2013 në vlerën 71,340 lekë. Të dyja faturat janë të barabarta me preventivat respektivë të hartuara nga Komuna, ku është përfshirë edhe vlera e TVSH -së. Në këto kushte kur operatori ekonomik është person fizik dhe puna e kryer është e barabartë me preventivat, si dhe kur shpenzimi është paraqitur me fatura të thjeshtë tatimore, rezulton të jetë përfituar padrejtësisht vlera e TVSH-së, që në rastin konkret është 11,688 lekë për faturën e parë dhe 11,340 lekë për faturën e dytë, **gjithsej 23,028 lekë të përfituara padrejtësisht nga subjekti fizik Z.Gj.**

Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **23,028 lekë**, përfituar padrejtësisht nga personi fizik Z.Gj, si pasojë e pagesës së kontratave të punëve për sistemimin e ujërave të zeza, kur subjekti nuk i nënshtrohet tvsh-së.

7.Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 95, datë 9.7.2014 në shumën 49,830 lekë është kryer pagesa me emërtimin “Për pije freskuese” mbi bazën e faturave të thjeshta tatimore nr. 9, datë 31.1.2013 në shumën 39,840 lekë dhe nr. 11, datë 16.6.2014 në shumën 9,990 lekë të lëshuara nga subjekti fizik Sh.P, të cilat edhe pse janë në kohë 1.5 vjet nga njëra tjetra kanë numër seria të njëjtë.

Në dokumentacionin e financës nuk rezulton që materialet të jenë bërë hyrje në magazinë dhe nuk dokumentohet me program pritje përcjellje qëllimi i përdorimit të tyre.

Rekomandimi: Shuma prej 49,830 lekë, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Shqiponja Prendi për blerje të artikujve pije freskuese e alkoolike, pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me program pritje përcjellje, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D me detyrë Kryetari i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe znj. D.P, si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në drejtim të furnizimit dhe përdorimit të karburantit u konstatua se pas lidhjes së kontratës për blerje karburanti, mbi bazën e prokurimit të kryer, u konstatua se për periudhën e vitit 2014 dhe të 6 mujorit të parë të vitit 2015 ishte blerë **9511.5 litra karburant**, me çmim mesatar 176.3 lekë/lit dhe vlerë gjithsej 1,676,895 lekë. Në dispozicion të Komunës Balldren i Ri është vetëm 1 automjet dhe ky në përdorim të administratës. Z. Gj.D, është autorizuar mbi bazën e urdhër dorëzimeve të lëshuara nga ish kryetar i Komunës Z.D për të tërhequr nga magazina të gjithë sasinë e karburantit të furnizuar, sipas blerjeve respektive të kryera.

Nisur nga sa më sipër për periudhën e vitit 2014 për 12 muaj dhe 6 mujorin e vitit 2015, gjithsej 18 muaj me normativën e shpenzimeve mujore të karburantit prej 250 litra në muaj, automjeti duhej të kishte harxhuar 4500 litra karburant.

Krahasuar me sasinë e furnizuar prej 9511.5 litra, rezulton të jenë harxhuar më shumë 5011.5 litra karburant, të cilat të vlerësuara me çmimin mesatar të llogaritur arrijnë vlerën 883,545 lekë, për të cilën duhet të përgjigjet tërheqësi i karburantit z. Gj.D dhe urdhëruesi z. Z.D.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të analizuar të gjitha veprimet administrativo-procedurale duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **883,545 lekë**, nga z. Gj.D, si tërheqës i sasisë së karburantit dhe personat e tjerë përgjegjës që përbën vlerën e 5011 litra karburant të tejkaluara nga normativa e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” z. Z.D me detyrë Kryetar i Komunës Balldren i Ri ka përfituar padrejtësisht për çdo muaj për vitin 2012 dhe vitin 2013 vlerën 15,000 lekë, nga e cila 135,000 lekë për vitin 2012 dhe 165,000 lekë për vitin 2013, gjithsej **300,000 lekë**, kur ligji i sipër cituar nuk ka miratuar financim mujor për funksionarët me detyrë “Kryetarë të komunave”.

Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **300,000 lekë**, nga z. Z.D ish Kryetar i Komunës e përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

10.Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion (Sistemim-Asfaltim) i Rrugës Balldren-Torovicë loti I-rë”, Balldren i Ri, Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,334,673 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Korçë dhe operatorit si mbikëqyrës të punimeve “K.....” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Balldren i Ri, Bashkia Lezhë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,334,673 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “KTHELLA” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 347 prot, datë 01.07.2013 “Rikonstruksion (Sistemim-Asfaltim) i Rrugës Balldren-Torovicë loti I-rë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të bankës në lidhje me pagesën e anëtarëve të këshillit dhe të kryepleqve të fshatrave komunës Balldren i Ri, rezultoi se për periudhën e auditimit janë hartuar listë prezencat të konfirmuar nga Kryetari i Këshillit të komunës dhe sekretari i këshillit dhe mbi këtë bazë janë hartuar listë pagesat përkatëse.

Disa anëtarë të këshillit komunës janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit të komunës e cila vërtetohet me auditimet që ju bënë pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillit të komunës

Sa më sipër rezulton se si rrjedhojë e mos marrjes pjesë të këshilltarëve në mbledhjet e këshillit të komunës Balldren i Ri për periudhën objekt auditimi është krijuar një dëm ekonomik në vlerën **1,844,614 lekë**, veprim në mos përputhje me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Këshilltari shpërblehet për punën që kryen. Masa e shpërblimit vendoset nga këshilli përkatës mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi”.

Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **1,844,614 lekë**, nga këshilltarët e Komunës Balldren i Ri .

12.Gjetje nga auditimi: Nga shoqëria Vodafone sha në territorin e komunës në vitin 2002, sipas kontratës datë 04.02.2002 është vendosur një antenë, duke marrë me qira një sipërfaqe toke truall prej 500 m², me afat qiraje 10 vjet (nga data 28.08.2002 deri më 28.08.2012), me vlerë qiraje vjetore 440,000 lekë. Pas përfundimit të kontratës, edhe pse operatori vazhdon të ushtroj aktivitetin dhe të ketë në përdorim territorin, Komuna Balldren nuk ka rilidhur kontratë qiraje. Në këtë mënyrë nga komuna Balldren, është lejuar që operatori privat Vodafone sha, të kryej shërbimin e tij pa pasur një marrëdhënie kontraktuale, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transformimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Balldren), ti kërkoj zyrtarisht operatori privat mobile “X...” sha, shlyerjen e detyrimit me dëm ekonomik krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën prej **1,700,000 lekë**, pasojë e përdorimit të territorit pa pasur një kontratë qiraje. Po ashtu ti kërkoj shoqërisë “X.....” sha, lidhjen e kontratës së qirasë, duke mbuluar edhe periudhën nga data 29.08.2012.

13. Gjetje nga auditimi: Me Aktmarrëveshjen nr. 887, datë 17.03.2009, lidhur nga Komuna Balldren, dhe C...Al.. shpk, është vendosur për dhënien në përdorim të truallit të Komunës Balldren, Kontrata është lidhur për një afat 30 vjeçar, mënyra e përdorimit është për Zonën e Parë për sipërfaqen prej 4.12 ha me qëllim përdorimi të fabrikës së çimentos, Zona e Dytë për sipërfaqen prej 16.65 ha dhe do përdoret për shfrytëzim minerar për 10 vitet e para , si dhe Zona e Tretë për sipërfaqen prej 29 ha që do të përdoret në vitin e 11 e mbrapa. Përfitimi ekonomik është në vlerën 10000 euro në vit ose ekuivalentimin në lek.

Me Kontratën nr. 888, datë 17.03.2009 lidhur nga Komuna Balldren dhe C....Al.... shpk, është dhënë në përdorim për 30 vjet një sipërfaqe prej 49.77 ha. Sipas kontratës, nenit 5 “Kohëzgjatja dhe mënyra e llogaritjes së afateve”, për sipërfaqen prej 20.77 ha, kohëzgjatja e qirasë është për 30 vjet nga data e nënshkrimit për parcelën e parë dhe 10 vjet duke filluar nga data e vënies në punë të fabrikës së çimentos për parcelën e dytë. Çmimi i qirasë është përcaktuar sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2016 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, lidhja 2 pika 5”, ku vlera e qirasë vjetore për sipërfaqen e tokës për ndërtimin e fabrikës së çimentos është 1,442,500 lekë (4.12 ha x 350,000 lekë), ndërsa vlera e qirasë vjetore për sipërfaqen e tokës për shfrytëzimin minerar është 6,493,500 lekë (16.65 ha x 390,000 lekë).

Aktmarrëveshja dhe kontrata janë lidhur në mungesë të një vendimi të Këshillit të Komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 30.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe në tejkalim të kompetencave pasi subjekti sipas Leje shfrytëzimi nr. 1276, datë 02.12.2008 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ka të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve dhe materialeve të ndërtimit për një afat 10 vjeçar (maksimumi 10 vjeçar) me të drejtë rinovimi çdo vit.

Nga dhënia me qira si tokë kullotë/livadh e sipërfaqes prej 4.12 ha me referencë ligjore VKM nr. 391, datë 21.06.2016 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar dhe jo sipas VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 291, datë 2.5.2012, VKM nr. 54, datë 05.2.2014 dhe VKM nr. 735, datë 5.11.2014, “Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose

enfiteozë”, Jashtë vijave kufizuese të këtyre bashkive, jo më pak se 100 (njëqind) lekë/m² në muaj; pra duke e trajtuar si tokë “Kullotë/Livadh” dhe jo si tokë “Truall”, është krijuar një dëm ekonomik, si vijon: $41200 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2/\text{muaj} \times 12 \text{ muaj} = 49,440,000 \text{ lekë}$ *ndërkohë kur nga subjekti për të njëjtën sipërfaqe paguhet 4.12 ha x 350,000 lekë = 1,442,500 lekë, pra 47,997,500 lekë, dëm ekonomik shkaktuar vetëm për një vit në buxhetin e shtetit/komunës. Për të gjithë periudhën mbi të cilën duhej të aplikohet ky detyrim ligjor rezulton në vlerën prej 335, 982,500 lekë (47,997,500 lekë x 7 vjet).*

Po ashtu nga mos reflektimi i referencës sipas kontratës nr. 888 datë 17.03.2009, hartuar me VKM nr. 391, datë 21.06.2016 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, lidhja 2 pika 5”, me VKM aktuale nr. 1064, datë 22.10.2010, është krijuar dëm ekonomik nga diferenca në çmim, të cilin VKM nr. 1064 22.10.2010, pika 6 “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë”, nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, nga 6-10 vjet, e ka përcaktuar në vlerën prej 440,000 lekë, pra nga periudha prej Nëntor 2010 deri më Qershor 2015, diferenca për tu paguar për sipërfaqen prej 16.65 ha është 166,500 lekë .

166,500 lekë në vit x 5 vjet (periudha e ndryshimit të VKM) = 832,500 lekë, dëm ekonomik i krijuar buxhetit të shtetit/komunës.

Për sipërfaqen prej 29 ha, që sipas Aktmarrëveshje nr. 887, datë 17.03.2009, është quajtur, Zona e Tretë për sipërfaqen prej 29 ha që do të përdoret në vitin e 11 e mbrapa, duke qenë se Leje shfrytëzimi nr. 1276, datë 02.12.2008, është dhënë për një afat kohor maksimumi 10 vjeçar, dhe për të cilën nuk ka vendim të këshillit bashkiak, kontrata duhej të lidhje brenda kësaj periudhe kohore, si sipërfaqe e vënë në dispozicion të shoqërisë, duhet të ishte lidhur kontratë qiraje, si dhe sipërfaqja tjetër lidhur sipas VKM nr. 888 datë 17.03.2009.

Nga mos lidhja e kontratës, lënia në përdorim pa asnjë akt ligjor, vetëm në iniciative të titullarit të NJQV, mos mbajtja e asnjë akti lidhur me përdorimin e saj jo vetëm është lejuar që të përdoret në mënyrë të paligjshme prona shtetërore, pa kërkuar qiranë vjetore, fillimisht sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, lidhja 2 pika 5”, dhe VKM aktuale nr. 1064, datë 22.10.2010, është krijuar dëm ekonomik nga diferenca në çmim, të cilin VKM nr. 1064 22.10.2010, pika 6 “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja karrierë”. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, nga 6-10 vjet e ka përcaktuar në vlerën prej 440,000 lekë është krijuar një dëm ekonomik në vlerën prej

Sipas VKM nr. 1064 është 29 ha x 440.000 lekë/ha/vit = 12,760,000 lekë x 5 vjet = 63,800,000 lekë

Sipas VKM nr. 391 është 29 ha x 390.000 lekë/ha/vit = 11,310,000 lekë x 2 vjet = 22,620,000 lekë

Në total dëmi ekonomik i krijuar si rrjedhojë e dhënies në përdorim pa kontratë qiraje, për të 7 (shtatë) vitet së bashku është në vlerën prej 86,420,000 lekë.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të negociuar kontratën me operatorin **C..Al. sh.p.k.** Njëkohësisht ti kërkoj zyrtarisht operatorit C....Al... shpk, pagesën e shumës prej **423,235,000 lekë, dëm ekonomik** krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përdorimit të referencave dhe tarifave të gabuara në dhënien me qira të pasurive komunare, për sipërfaqen prej 4.12 ha dhe 16.65 ha, si dhe tejkalim të kompetencave në dhënien në përdorim pa përcaktuar pagesë, për sipërfaqen prej 29 ha, **në të kundërt çështja të ndiqet zyrtarisht në gjykatë.**

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës,

në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i **kërkojmë** Kryetarit i Bashkisë Lezhë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

1. D.P, përgjegjëse e Sektorit të Financës, anëtare e Njesisë së Prokurimit

Në kundërshtim me ligjin 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar e kontrollin”, janë kryer shpenzime me urdhër shpenzimit nr. 114, datë 24.9.2013, për shumën 379,800 lekë dhe nr. 115, datë 24.7.2014, për shumën 384,000 lekë ishte paguar personi fizik “L..” mbështetur në faturën tatimore nr. 55, datë 24.9.2013 me përshkrimin “Shërbime televizive, njoftime për biznesin, sensibilizim investimesh, njoftim pagesa taksash, mesazhe sensibilizuese mbi mjedisin, urime festash, aktivitete të ndryshme” pa e justifikuar me punë konkrete.

Me urdhër shpenzimit nr. 43, datë 11.4.2014 me vlerë 340,008 lekë me TVSH ishin kryer pagesa për “Blerje materiale për sistemim rrjeti elektrik dhe lyerje për shkollat e qendrën shëndetësore”, mbi bazën e faturës tatimore nr. 374, datë 27.9.2012, të lëshuar nga subjekti fizik Gj.S. **Shuma prej 340,008 lekë**, që përbën vlerën e paguar subjektit fizik Gj.S, pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve.

Me urdhër shpenzimit nr. 68, datë 21.5.2014 me vlerë 398,862 lekë me TVSH ishin kryer pagesa për “Blerje materiale për sistemim rrjeti elektrik dhe riparime të pjesshme, lyerje të zyrave të komunës, shkollave kopshteve e qendrën shëndetësore”, mbi bazën e faturës tatimore nr. 2, datë 5.1.2013, të lëshuar nga subjekti fizik Gj.S. **Shuma prej 398,862 lekë**, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Gj.S, pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve.

2. Gj.Ç jurist, anëtar i Njesisë së Prokurimit

3. S.T inxhinier, anëtar i Njesisë së Prokurimit

Në dosjen e tenderit të karburantit ka mungesa të dokumentacionit, e konkretisht:

- Mungon kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit.
- Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe fondit limit.
- Mungon miratimi i regulesve teknike nga titullari i Komunës.
- Kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga specialisti i ngarkuar.
- Nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Komunës dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet.
- Nuk është evidentuar çmimi i karburantit i përdorur dhe marzhi i fitimit i marrë për bazë në llogaritjen e fondit limit.

Në dokumentet e tenderit mungojnë kërkesat kualifikuese që operatorët ekonomikë të paraqesin për:

- Numrin e punonjësve të siguruar të vërtetuar me dokumente nga organet kompetente;
- Është kërkuar disponimin e një pike të shpërndarjes së karburantit në pronësi, ose me qira, por nuk është përcaktuar dokumentacioni që duhet të paraqesin për të dokumentuar me vërtetim hipotekar dhe kontratë qiraje, sipas rastit pronësinë;
- Nuk janë kërkuar paraqitja e pasqyrave financiare dhe bilanceve për 3 vitet e fundit të konfirmuara nga organet tatimore.
- Nuk janë kërkuar paraqitja e xhiros vjetore për 3 vitet e fundit të konfirmuara nga organet tatimore.

-Nuk janë kërkuar paraqitja shlyerje së taksave vendore për 3 vitet e fundit të konfirmuara nga njësitë vendore ku zhvillon veprimtarinë.

4. Naim Cara Anëtar i KVO-së

5. Altin Mema Anëtar i KVO-së

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se dokumentacioni kualifikues i operatorëve ekonomikë kishte këto mangësi:

- Operatori ekonomik Shoqëria “A.....Petroleum” sh.p.k është skualifikuar se adresa e pikës së karburantit është Shëngjin Lezhë.

- Operatori ekonomik Shoqëria “L...-80” sh.p.k. i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues pasi:

a. përshkrimi i ofertës nuk është plotësuar në mënyrën e duhur sipas kërkesave të shtojcës 1, sepse nuk është llogaritur çmimi i karburantit sipas çmimit të bursës Reuters dhe shtesave fiskale, por vetëm me masën e marzhit të fitimit, ku dhe ky është dhënë vetëm në vlerë dhe jo në përqindje.

b. Nuk ka paraqitur asnjë dokument për punë të ngjashme të realizuar për tre vitet e fundit në vlerën 40,000 lekë, kërkesë kjo e dokumenteve të tenderit.

c. Nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë së disponon një pikë karburanti në një largësi prej 5 km nga Komuna Balldren.

d. Bilanci kontabël i vitit 2012 i paraqitur është i pa konfirmuar nga organet tatimore.

e. Autorizimi i tregimit të karburantit është lëshuar nga Komuna Shëngjin.

f. Në fletë analizën e paraqitur nuk janë përcaktuar 3 tregues të cilësisë së karburantit të kërkuar në specifikimet teknike.

Në këto kushte Operatori ekonomik Shoqëria “L...-80” sh.p.k duhej të ishte skualifikuar.

6. Znj. Prenda Sejdia, me detyrë, përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave.

7. Z. Skënder Ulaj me detyrë inspektor i Zyrës së Taksave.

Për vjeljen e detyrimeve tatimore nga ana e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore në Komunën Balldren i Ri, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:

-nuk i është dërguar lista e subjekteve debitore zyrtarisht Zyrës së Financës.

-nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë të Policisë së Komunës dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitore, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-subjektet që nuk i kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre nuk ishte bërë llogaritja e kamat vonesave në masën 5 për qind në muaj, por jo më tepër se në masën 25 për qind, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”. Llogaritjet u bënë gjatë auditimit, por për to nuk kanë dijeni subjektet private tatimpaguese.

-nuk është kërkuar që ndaj subjekteve debitor vendosja e barrës siguroese (Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”, dhe konkretisht në nenin 91.

Mosrealizimi i planit të ardhurave, përveç faktorëve që cituam më sipër ka ardhur dhe nga moszbatimi i legjislacionit tatimor, si ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” me ndryshime etj, për të cilët bëjnë përgjegjës për shkeljet e trajtuara në raport.

8. Ferdinand Ujkaj me detyrë inspektor i Zyrës së Taksave dhe Kryetar i KVO-së.

Për vjeljen e detyrimeve tatimore nga ana e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore në Komunën Balldren i Ri, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:

-nuk i është dërguar lista e subjekteve debitor zyrtarisht Zyrës së Financës.

-nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë të Policisë së Komunes dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitor, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-subjektet që nuk i kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre nuk ishte bërë llogaritja e kamat vonesave në masën 5 për qind në muaj, por jo më tepër se në masën 25 për qind, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”. Llogaritjet u bënë gjatë auditivit, por për to nuk kanë dijeni subjektet private tatimpaguese.

- Në disa raste u janë dërguar Bankave *urdhrrat e bllokimit të llogarive në bankat, për subjektet debitor, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008*” Për procedurat tatimore”.

-nuk është kërkuar që ndaj subjekteve debitor *vendosja e barrës siguroese (Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”, dhe konkretisht në nenin 91

Mosrealizimi i planit të ardhurave, përveç faktorëve që cituam më sipër ka ardhur dhe nga moszbatimi i legjislacionit tatimor, si ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” me ndryshime etj, për të cilët bëjnë përgjegjës për shkeljet e trajtuara në raport.

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se dokumentacioni kualifikues i operatorëve ekonomikë kishte këto mangësi:

- Operatori ekonomik Shoqëria “A....Petroleum” sh.p.k është skualifikuar se adresa e pikës së karburantit është Shëngjin Lezhë.

- Operatori ekonomik Shoqëria “L..-80” sh.p.k. i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues pasi:

a. përshkrimi i ofertës nuk është plotësuar në mënyrën e duhur sipas kërkesave të shtojcës 1, sepse nuk është llogaritur çmimi i karburantit sipas çmimit të bursës Reuters dhe shtesave fiskale, por vetëm me masën e marzhit të fitimit, ku dhe ky është dhënë vetëm në vlerë dhe jo në përqindje.

b. Nuk ka paraqitur asnjë dokument për punë të ngjashme të realizuar për tre vitet e fundit në vlerën 40,000 lekë, kërkesë kjo e dokumenteve të tenderit.

c. Nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë se disponon një pikë karburanti në një largësi prej 5 km nga Komuna Balldren.

d. Bilanci kontabël i vitit 2012 i paraqitur është i pa konfirmuar nga organet tatimore.

e. Autorizimi i tregimit të karburantit është lëshuar nga Komuna Shëngjin.

f. Në fletë analizën e paraqitur nuk janë përcaktuar 3 tregues të cilësisë së karburantit të kërkuar në specifikimet teknike.

Në këto kushte Operatori ekonomik Shoqëria “L....-80” sh.p.k duhej të ishte skualifikuar.

9. Gjyste Dushku Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës.

-Nga ana e Komunes Balldren nuk është bërë miratimi i “Kërkesës për fillimin e procesit të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të komunës Balldren”

-Nuk është bërë depozitimi i lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar neni 70/12 “Depozitimi i lejes zhvillimore”.

Nga auditimi i dosjeve të vëna në dispozicion nga Sektori i Urbanistikës rezultoi se:

Dosja nr. 1, datë 29.05.2014, Kryetari i Komunes Balldren për zhvilluesin “Gj... ” shpk në cilësinë e sipërmarrësit të kryerjes së punimeve ka miratuar Leje Zhvillimore Ndërtimi për objektin “Magazinë 1 kat për linjë përpunimi, seleksionimi dhe tharje gështenjash”, në zonën

kadastrale 1873 fshati Gocaj , Komuna Balldren me investitor dhe pronar toke Tone Mazreku. Në këto leje është përcaktuar afati i lejes deri me datën 30.12.2014. Leja zhvillimore për subjektin “Gjergji”shpk, është dhënë sipas pretendimeve të tyre sipas VKM nr. 199, datë 02.04.2014 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 480, datë 22.06.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin rregullores model të planifikimit”, të ndryshuar:

Nga Bashkia Lezhë, ku bën pjesë Njësia Administrative Balldren i Ri(ish komuna), është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Abdulla Duka, Vasillaq Peci dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT